

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-069/2015

**Prishtinë
7 Dhjetor 2016**

Në çështjen juridike të:

R. V.

Në emër të bashkëshortit të ndjerë

M. V.

Pala ankuese

Kundër

Pala përgjegjëse në ankesë

Askush

Kolegji i Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronave, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini Kryetar i Kolegjit, Gjyqtarët Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/228/2014 lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave më tej AKP me numrin KPA133315 i datës 13 Mars 2014, pas seancës gjyqësore kryesore, të mbajtur më 7 Dhjetor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e R. V. e paraqitur kundër vendimit të KKPK/D/A /228/2014 i datës 30 Mars 2014 sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numrin KPA33315, refuzohet si e pabazuar.
2. Konfirmohet vendimi i KKPK/D/A /228/2014 i datës 30 Mars 2014 sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numrin KPA33315.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 23 Mars 2007, M. V, ka parashtruar një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronave (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP) e regjistruar në nr. KPA33315, duke kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore dhe kthimin e posedimit të ngastrës kadastrale nr 208 që ndodhej në fshatin Korenicë të Gjakovës me sipërfaqe prej 1.91.34 h(në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar). M. V. kishte deklaruar se është pronar i pronës së kërkuar dhe se e ka humbur posedimin ndaj pronën në qershor të vitit 1999.
2. Për ta mbështetur kërkesën, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut Nr. 561/81 në Pejë i datës 9 janar 1986 që dëshmon se R. V. është pronare e ngastrave 206 dhe 207 dhe një pjese të ngastrës 208 dhe obligohet Ndërmarrja shoqërore “Ereniku” që t’ia mundësoi posedimin e papenguar.
 - Kontratë për mbajtjen e përrjetshme e lidhur mes M. V. si mbajtjes dhe M. V. e mbajtura e lidhur në Beograd me 8 Janar 1987 e certifikuar në Gjykatën e V- të (pestë) Komunale në Beograd me numër Posl.Br.R.1342/87
 - Aktvendim të Gjykatës Komunale në Gjakovë Nr 3886/87 të lëshuar me 20 Mars 1987 me të cilin konstatohet se një pjesë e ngastrës kadastrale nr 208 i është dhënë në ruajtje M. V.

- Certifikatë e Vdekjes nr 06734 e lëshuar nga Komuna Savski Venac që dëshmon se M. V. kishte ndërruar jetë me 12 Nëntor 1990.
 - Certifikatë e Vdekjes nr 5076 e lëshuar nga autoritetet e Qytetit të Beogradit që dëshmon se M. V. kishte ndërruar jetë me 27 Gusht 2010. Certifikate e Vdekjes ishte dorëzuar nga R. V. (pala ankuese)
3. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ,sipas detyrës zyrtare kishte gjetur se ngastrat nr 206, 207 dhe 207 nuk kanë të bëjnë me lokacionin e Korencës por ndodhen në fshatin Baba i Bokës dhe për këtë kishin kërkuar historikun e ndryshimeve kadastrale që të provonin nëse prona e kërkuar ishte pronë shoqërore ose e regjistruar në emër të personave të tretë.
 4. Sipas të dhënave të zyrës kadastrale në Gjakovë të datës 21 Korrik 2009 ngastrat evidentoheshin si pronë e ndërmarrjes shoqërore “Ereniku”. Fleta Poseduese i ishte bashkangjitur historikut në lidhje me pronat.
 5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, sipas raportit të Notifikimit të datës 14 Nëntor 2008, ka konstatuar se prona e kërkuar nuk mund të identifikohet mbi bazën e të dhënave nga paraqitësi i kërkesës dhe për këtë arsye identifikimi i pronave të kërkuara ishte bërë duke u publikua në të gjitha vendet publike dhe nga drejtoria kadastrale u morr konfirmimi se as M. e as M. V. nuk figurojnë si pronarë në asnjë nga Fletat Poseduese të mëparshme e as të tanishme në të dhënat kadastrale në Gjakovë.
 6. Sipas Raportit të Verifikimit të datës 28 Janar 2014, Kontrata për mbajtje të përhershme Posl.Br.R.1342/87 e vitit 1987 ishte verifikuar pozitivisht kurse Fleta Poseduese, Aktgjykimi C.Nr. 561/1981 si dhe Vendimi I.Br.3866/87 nuk ishin gjetur në arkivat përkatëse si pasojë verifikimi rezultoi të jetë Negativ.
 7. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/228/2014 të datës 30 Mars 2014 ka vendosur që kërkesa të refuzohet, me arsyetim se paraqitësi i kërkesës fillimisht kishte deklaruar se e ka humbur posdimin si pasojë e konfliktit të armatosur por në bazë të dokumentave të parashtruara dhe kërkimeve “ex officio” të Sekretariatit ka rezultuar se ai nuk ka mundur të paraqes asnjë dëshmi valide se para ka pasur ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar, konfliktit të armatosur dhe që të njetën e ka humbur si pasojë e konfliktit.
 8. M.V.ka ndërruar jetë me 27 Gusht 2010 dhe R.V. në cilësinë e palës ankuese, në emër të bashkëshortit të ndjerë, vendimin e Komisionit e ka pranuar më 28 Gusht 2014, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 26 Shtator 2014.

Pretendimet Ankimore

9. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është marr në shkelje për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Më tej pala ankuese e kundërshton arsyetimin e KKPK-së se prona nuk është humbur si rezultat i konfliktit duke pohuar se dokumentet e parashtruara dëshmojnë pronësinë e bashkëshortit të saj të ndjerë. Për më tepër ajo pretendon se për faktin se askush nuk e ka kontestuar

kërkesën KKPK-ja do të duhej ta njihte pronësinë dhe të kthente posedimin mbi pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

10. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejshëm LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e Aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se ankesa është e pranueshme dhe e afatëshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së për arsye se pala ankuese vendimin e Komisionit e ka pranuar më 28 Gusht 2014, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 26 Shtator 2014. Nga kjo mund të konstatohet se ankesën e ka paraqitur në afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se *“ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit”*.

Meritat e Ankesës

Gjykata gjeti se Ankesa e parashtruar ndaj vendimit të Komisionit është e pa bazuar për faktin se bashkëshorti i palës ankuese nuk ka dëshmuar të drejtë pronësore të regjistruar në regjistra publik dhe se të njëjtën e ka humbur si pasojë e konfliktit të armatosur dhe rrethave që lidhen me konfliktin. Në të dhënat kadstrale të Komunës së Gjakovës dhe ato të zhvendosura (dislokuara) në Serbi nuk figuron bashkëshorti i palës ankuese si pronar.

Juridiksioni

11. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për t'i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999: (a) kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe (b) kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, ku pretenduesi i pronës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat të tilla pronësore.

12. Për këtë lëndë, është e nevojshme të përcaktohet nëse bashkëshorti i palës ankuese ka pas prova se ka qenë pronar i pronës së kërkuar, se e ka pas në shfrytëzim dhe se e ka humbur si pasojë e konfliktit. Të dhënat kadastrale tregojnë se gjatë kohës së konfliktit prona ka qenë e regjistruar si shoqerore. Neni 20 i Ligjit mbi Mardhënjet pronësore juridike (Gaz.Zyrtare e RSFJ Nr 6/80, 36/90 parasheh se “*E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj*”- që nënkupton formën me shkrim vërtetimin e autoritetit dhe regjistrimin e pronës në regjistra publik. Edhe Ligji aktual nr. 03/L-154 Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në nenin 36 parasheh se “*1. Për bartjen e pronësisë në paluajtshmeri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri.*”
13. Pala ankuese nuk ka dëshmuar se bashkëshorti i saj para konfliktit e kishte ekzekutuar Aktgjykimin dhe se ka pas të drejtë pronësore dhe posedim mbi pronën e kërkuar të cilën e ka humbur si pasojë e konfliktit dhe ky konstatim i KKPK-së nuk u kundërshtua me asnjë provë të re sipas ankesës.
14. Ky aktgjykim nuk paragjykon asnjë të drejtë pronësore të konfirmuar për shfrytëzuesin aktual dhe nuk është pengesë për konfirmimin e të drejtave pronësore në procedurë të rregullt.
15. Duke pas parasysh të mësipërmen, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

16. Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit,

Beshir Islami, Gjyqtar

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gutaityde, Referent i EULEX-it